



Pranuar / Dorezuar Punimje/Prodato Received/Delivery	09.03.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRISTUK	1258/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.134/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardit Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.134/2022 të datës 15.02.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi:

[redacted] kundër organit të punësimit Qendra e Studentëve, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 09.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.134/2022 të datës 15.02.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] përmes postës së Kosovës më datë 12.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (e pranuar me datë 15.02.2022), kundër Njoftimit të datës 12.01.2022 të Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 23.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Qendra e Studenteve, ndërsa më datë 03.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot: 785/2022 të datës 15.02.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë në numër të protokollit 950/2022 të datës 23.02.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1134/2022 të datës 03.03.2022; Konkursin me numër të protokollit 137 të datës 26.10.2021; Testet me shkrim të datës 20.12.2021 të të gjithë kandidatëve të cilët kanë mbi 50 pike të fituara së bashku me dosjet e tyre; Testet me shkrim të datës

20.12.2021 të të gjithë kandidateve që nuk kanë arritur mbi 50 pikë së bashku me dosjet e tyre; Formularët për vlerësimin individual të kandidatëve; Përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Emalin e datës 08.02.2022; Raportin e datës 13.01.2022 lidhur me kandidatet e përzgjedhur; Listën e gjerë e aplikanteve; Njoftimin e datës 12.01.2022 për kandidatet e përzgjedhur; Formën për listën e ngushtë të datës 17.12.2021; Aktvendimin me numër 266 të datës 14.12.2021; Ankesën me numër 04/1 të datës 13.01.2022; Përgjigjen në ankesë me numër 4/2 të datës 17.01.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke shqyrtuar provat e lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën A.nr.134/2022 të datës 15.02.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] *sepse:*

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Qendra e Studentëve, ka shpallur konkursin me numër të protokollit 137 të datës 26.10.2021 tre (3) vende të lira në pozitën "Recepcionist", në të cilin ankuesi ka marr pjesë në procedura të rekrutimit deri në fazën e fundit ndërsa me datën 12.01.2022 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Qendrën e Studentëve në *webfaqen* e saj ka publikuar listën me kandidatet e përzgjedhur për pozitën "Recepcionist" Klasa e pozitës profesionale 4 në Qendrën e Studenteve, ku në këtë listë nuk figuron emri i ankuesit.

Ankuesi i pa kënaqur me listën përfundimtare të datës 12.01.2022, lidhur me përzgjedhjen e kandidateve me të suksesshëm, më datë 13.01.2022 ka parashtruar ankesë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore pranë Qendrës së Studenteve, ndërsa më datë 17.01.2022 Kryetari i Komisionit në Qendrën e Studenteve përmes shkresës me numër 4/2 i është përgjigjur ankuesit se pas kalkulimit të pikëve ju keni fituar 52 pikë në total ndërsa kandidatet e përzgjedhur kanë pasur pikë me shumë.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen me numër 4/2 të datës 17.01.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën "Recepcionist" ka pasur shkelje procedurale dhe moszbatim të bazës ligjore të legjislacionit në fuqi, si dhe vlerësim i padrejtë nga ana e Komisionit Vlerësues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë ndahen në: *nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës*" si dhe bazuar në paragrafin 6 të të njëjtit nen ku theksohet se: "*Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike*", konstatoi se pozita "Recepcionist" hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit administrativ dhe mbështetës, rrjedhimisht pozita në fjalë nuk është pozitë e shërbimit civil. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.134/2022 të datës 15.02.2022 të parashtruar nga ankuesi

Sipas nenit 79 paragrafi 2 dhe nenit 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e

punës. Kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji udhëzon ankuesin se nëpunësi administrativ dhe mbështetës ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.134/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Qendrën e Studenteve;
- Udhëheqësit të Personelit në Qendrën e Studenteve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;